

UNIONI EVROPIAN

MËSOJMË
DREJTËSI

Unioni evropian - Mësojmë drejtësi

Botues:

Fondacioni Instituti shoqëri e hapur - Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Millçin, drejtor ekzekutiv

Redaktorë:

Fani Karanfilova Panovska

Kire Milovski

Autor:

Qendra maqedonase për arsimim evropian

Perkthimi:

Hava Leskovica

Lekturë:

Besnik Emini

Dizajn dhe përgatitje:

Brigada Dizajn

Shtyp:

Skenpoint

Tirazhi:

1000 kopje

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје
341.171 (4-672ЕУ)

UNIONI evropian - mësojmë drejtësi / [redaktorë Fani Karanfilova Panovska,
Kire Milovski], - Shkup : Fondacioni Instituti shogëri e hapur - Maqedoni, 2009, -
42 стр. : илустр. : 24 см

ISBN 978-608-218-042-7

а) Европска унија - Прирачници
COBISS.MK - ID 80369418

Hyrje

Kjo broshurë paraqet plotësim të doracakut “Mësojmë drejtësi”, që u botua nga Fondacioni Instituti shoqëri e hapur - Maqedoni për nevojat e Programit të Forumit rinor arsimor, “Mësojmë drejtësi”.

Në të njëjtën kohë kjo broshurë është e përpunuar edhe për nevojat e projektit “Aksion për Evropën”, i realizuar nga Fondacioni Instituti shoqëri e hapur - Maqedoni në partneritet me Qendrën maqedonase për arsimim evropian dhe Forumi rinor për arsimim, që parasheh promovim të UE-së në nivel lokal, nëpërmjet të debateve dhe trajnimeve.

Qëllimi i broshurës është që të njofton nxënësit e shkollave të mesme, në fakt të rinjtë e Republikës së Maqedonisë, me karakteristikat bazë të Unionit Evropian, institucionet e saja dhe mënyrën e marrjes së vendimeve në to, si dhe për rrugën të cilën Republika e Maqedonisë duhet ta kalon deri në anëtarësimin e plotë në Unionin.

Nëpërmjet të trajnimeve të programit “Mësojmë drejtësi” të Forumit rinor arsimor, shpresojmë që kjo broshurë do të arrijë deri në duart e shume nxënësve të shkollave të mesme të Republikës së Maqedonisë dhe e njëjta do të jetë udhëheqës në procesin e euro-integrimit të tërë shoqërisë sonë. Në fakt, në Unionin Evropian nuk hyjnë vetëm qeveria dhe partitë politike, por para se gjithash qytetarët, kurse institucionet shtetërore duhet të punojnë në shërbim të interesave të tyre. Ai interes quhet Unioni Evropian dhe i njëjti duhet të mundëson standard më të mirë jetësor, institucione stabile dhe demokratike, arsimim më të mirë, respektim dhe realizim të drejtave dhe lirive njerëzore, demokraci dhe sundim të drejtësisë.

Nga redaktorët

ÇFAR ËSHTË E PËRBASHKËT NË UNION?

Të bashkuar në dallimet

Për momentin, Unioni bashkon 27 vende, me më pak ose më shumë ekonomi të zhvilluara, me sisteme të ndryshme, shumë tradita dhe karakteristika kulturore, dhe të gjitha shtetet i vlerëson dhe i përkrah në mënyrë të njëjtë. Nga aty edhe motoja e Unionit - “Të bashkuar në dallimet”. Unioni Evropian u krijua dhe zhvillohet për tu mundur jetë më të sigurt dhe më të lirë

Flamuri

Dymbëdhjetë yjet e verdha të prapavijës së kaltër të errët janë pamje e shpeshtë edhe në vendin tonë, e cila edhe pse ende nuk është anëtare e Unionit, përsëri është në bashkëpunim të përhershëm dhe zhvillon partneritet me Unionin dhe vendet anëtare të saj. Ky flamur është simbol i UE, por edhe simbol i Evropës së bashkuar në

qytetarëve të saj. Ajo nuk ekziston që ti zëvendëson shtetet që janë anëtare të saj, por përmes politikave dhe aksioneve të përbashkëta ta rrit dhe ta siguron zhvillimin ekonomik, begatin, paqen dhe sigurinë. Më poshtë shqyrtojmë disa nga këto politika dhe karakteristika të përbashkëta:

përgjithësi. Në shumë tradita numri 12 është simbol i harmonisë dhe perfeksionit, kurse rrethi, ndër të tjerat, simbol i tërësisë dhe bashkimit. Prandaj pa marr parasysh zgjerimin e Unionit dhe rritjen e numrit të anëtarëve të saj, numri i yjeve në flamur mbetet 12.

Himni

Edhe himni i UE flet për idealin e bashkëpunimit dhe vëllazërimit mes popujve, dhe pasi për këtë ideal ka kompozuar edhe Betoveni, melodija e tij nga simfonia e Nëntë e njohur si “Oda e gëzimit” bëhet himni i Unionit. Himni nuk i zëvendëson himnet kombëtare të vendeve anëtare të Unionit, por është edhe një mënyrë që vërteton dhe përgëzon mundimet për bashkim të dallimeve.

Austria,
Belgjika,
Bullgaria,
Britania
e Madhe,
Gjermania,
Greqia,
Danimarka,
Estonia,
Irlanda, Italia,
Qiproja,
Latvia,
Lituania,
Luksemburgu,
Malta,
Polonia,
Portugalia,
Romania,
Sllovenia,
Sllovakia,
Hungaria,
Finlanda,
Franca,
Holanda,
Çekia, Suedia,
Spanja.

9 Maji - Dita e Evropës

Në këtë ditë, në vitin 1950, Robert Shuman e prezantoi propozimin e tij për bashkimin e Evropës dhe sigurimin e paqes dhe begatisë të qytetarëve të saj. Propozimi i njohur si "Deklarata e Shuman-it" është themel për krijimin e bashkësive që përgjatë viteve e krijuan atë që

sot njihet si Union Evropian.

Për atë, 9 maji sot festohet si ditë e Evropës dhe është ditë kur qytetarët e Unionit organizojnë festivale të ndryshme të përkushtuara bashkimit në Evropë dhe afrimit reciprok.

Euro

Kujtohuni sa përgatitje shtesë duhet kur shkoni në shtetet e jashtme- informim cilat valuta (para) përdoren në shtetet të cilat do ti vizitoni, ndërri- rim i të hollave në bankë, kujdes ndaj dallimeve të kursit, organizim i valutave të ndryshme etj. Nga viti 2002 shumica e qytetarëve në UE nuk duhet të brengosen për situata të tilla, pasi që prej atëherë fillon përdorimi i valutës së përbashkët - euro. Përdorimi i valutës së njëjtë e lehtëson tregtinë dhe i çliron qytetarët nga brengat që i përmendëm.

Për momentin, euron e përdorin 13 anëtare të Unionit (Belgjika, Gjermania, Greqia, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia, Sllovenia, Finlanda dhe Spanja). Simboli grafik për euron (€) është i inspiruar nga shk-

ronja greke epsilon dhe i dedikohet shkronjës së parë të Evropës. Shkurtesa zyrtare që përdoret për euron është EUR. Bankënotat e të hollave, të njëjta në të gjitha vendet e Euro-zonës, janë të dizajnuar nga fituesit e garës që u mbajt në UE, kur u ftuan të gjithë të interesuarit të ofrojnë ide të tyre për pamjen e bankënotave. Monedhat në njërin anë kanë simbol të përbashkët, ndërsa në anën tjetër përfaqësohen disa tipare nacionale të shteteve-anëtare. Prandaj mos u habitni nëse në ndonjë supermarket në Austri ju japin monedhë me fotografi të shkrimtarit spanjoll Servantes, ose nëse në Halkidiki paguani me para me fotografinë e mbretëreshës holandeze Beatriks.



Liria e Lëvizjes së njerëzve dhe Shengeni

Sot qytetarët e UE mund të udhëtojnë nga Lisbonë në Helsinki nëpërmjet Barcelonës, Nicës, Torinos dhe Vjenës pa kaluar nëpër kufij dhe pa u brengosur për dokumentet e udhëtimit. Të gjitha vendet anëtare janë pjesë e sistemit pa kufij Shengen, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar,

Danimarkës, Bullgarisë dhe Rumanisë. Këtë liri të lëvizjes Unioni ua jep edhe të gjithë qytetarëve nga vendet e treta të cilët legalisht qëndrojnë në ndonjë vend nga zona e Shengenit.

Liria e lëvizjes së punëtorëve

Nëse e shikoni listën e të punësuarve në "Folsfagen", sigurisht do të gjeni ndonjë Portugalez, Danez ose Grek. Kjo mundësohet nëpërmjet të lirisë se lëvizjes së punëtorëve, që ju garanton të

drejtë të njëjtë për punësim qytetarëve të UE në cilindo vend - anëtarë, pa marr parasysh shtetësinë e tyre.

Programe për arsim

Njerëzit e rinj dëshirojnë të takojnë njerëz tjerë të rinj, dëshirojnë të shohin vende tjera dhe të mësojnë për traditat e ndryshme. Shume të rinj përpiqen dhe mundohen që një pjesë të arsimit të tyre ta realizojnë në shtete tjera, por kjo komplikohet për shkak të harxhimeve të mëdha dhe procedurave të gjata. Studentët e rinj të Unionit, që moti nuk brengosen për këto vështirësi.

Ekzistojnë më shumë programe që ju ndihmojnë të rinjve ti realizojnë këto plane (Erasmus, Leonardo, Komenius dhe Grundvig). Këto programe sigurojnë që diplomat e marra nga cilido universitet të pranohen gjithkund në Union. Më shumë se dy milion të rinj në EU tashmë e kanë shfrytëzuar këtë mundësi.

Tregtia dhe dogana

Domatet greke tashmë pesë dekada shumë më lirë dhe më thjeshtë arrijnë në tregjet gjermane, sepse nuk janë të ngarkuar me të dhëna dhe procedura doganore. Që nga viti 1957, Evropianët u morën vesh që tu lejojnë prodhuesve të tyre ti plasojnë prodhimet e tyre në tregun përgjatë Unionit dhe të mos japin të dhëna shtesë. Kjo politikë e përbashkët, qytetarëve të UE-së u mundësoi të kenë qasje deri te prodhimet më të lira, më të ndryshme dhe më kualitative në të gjithë pjesët e Evropës.

Edhe Maqedonia ka marrëveshje me Unionin, me të cilën shumë prodhime maqedonase mund të

arrijnë në tregjet evropiane, pa u ngarkuar me doganë.

Investim i përbashkët në zhvillimin ekonomik- ndihmë të territoreve më pak të zhvilluara

UE është një ndër pjesët më të zhvilluara në botë, por megjithatë ka lëmi që janë shumë më të varfra nga të tjerat. Duke tentuar që të gjithë qytetarët e EU-së të jetojnë më mirë, vendet - anëtare i bashkojnë forcat e tyre dhe fuqinë financiare, dhe së bashku ndihmojnë rajonet e varfra të zhvillohen dhe të pasurohen. Rreth 30 miliardë në vit shfrytëzohen për ndihmën e ekonomive të

këtyre rajoneve, për krijimin e vendeve të reja të punës dhe për kualifikim të qytetarëve të papunësuar. Kjo ndihmë është më shumë e dukshme në Irlandë e cila para dhjetëra viteve ishte vendi më i varfër në UE, kurse tash është një nga bartësit e zhvillimit ekonomik..

Buxheti

Që të zhvillohen qëllimet e zhvillimit dhe të be-gatisë, anëtarët e UE vendosën të krijojnë qese të përbashkët të parave, përkatësisht buxhet evropian. Në fakt, Unioni ka shumë programe për punë, por nuk ka aftësi të mbledh tatime nga

qytetarët dhe firmat me të cilat do të mund ti financonte ato programe. Prandaj, çdo anëtarë jep pjesë nga të ardhurat e saj (dogana, TVSH) në buxhetin evropian.

INSTITUCIONET E UNIONIT EVROPIAN

Në tokën Evropiane ekzistojnë kultura dhe tradita të ndryshme, megjithatë edhe vlera të përbashkëta për popujt evropian. Shtetet bashkuara demokratike Evropiane, përmes bashkëpunimit ekonomik dhe politik synojnë kah sigurimi i prosperitetit dhe paqes së përhershme. Dëshirat për sigurim dhe paqe, për liri dhe lëvizje të lirë, si dhe begatia ekonomike janë thellë të rrënjëzuara në arsyet e ekzistimit të Unionit Evropian.

Sikurse karakteri i çdo vendi- anëtar i UE është i definuar nga sistemi juridik dhe institucionet nacionale, ashtu edhe karakteri i UE-së është i definuar nga institucionet e ndryshme dhe trupat dhe përgjegjësia e tyre. Prandaj është me rëndësi për të pasur njohuri themelore për organizimin dhe metodat e punës së institucioneve në Unionin Evropian. Kjo mundëson të kuptohet procesi i krijimit të politikave, në fakt si përgatiten, sillen, implementohen dhe monitorohen vendimet.

Në Unionit Evropian ekzistojnë institucione dhe trupa të ndryshme. Megjithatë, vetëm pesë janë të definuar si institucione dhe llogariten si më të rëndësishme.

Parlamenti Evropian

Parlamentin evropian e përbëjnë 732 euro-parlamentar me mandat pesëvjeçar. Ky është UE-institucion i vetëm anëtarët e të cilit janë direkt të zgjedhur nga qytetarët e UE-së- që kanë të drejtë vote. Secila anëtare e UE-së zgjedh numër të ndryshëm të deputetëve që më herët është i caktuar proporcionalisht me popullatën e secilit shtet. Kështu për shembull Gjermania zgjedh 99 deputet, kurse Malta 5.

Deputetët në parlamentin Evropian nuk mblihen sipas përkatësisë nacionale, por në grupe politike, varësisht nga përkatësia partiake. Në këtë mënyrë Euro-parlamentarët nëpërmes parlamentit Evropian i përfaqësojnë interesat e të gjithë qytetarëve në Union, jo vetëm të shtetit në të cilin janë zgjedhur. Për këtë Qytetarët e UE-së mund të zgjidhen dhe mund të jenë të zgjedhur për deputet në parlamentin Evropian në cilën do qoftë anëtare të Unionit, pa marr parasysh shtetësinë e tyre.

Çdo anëtar i Unionit zgjedh numër të ndryshëm deputetësh, që paraprakisht është i përcaktuar në proporcion me popullatën e secilit shtet. Kështu për shembull Gjermania zgjedh 96 deputet, kurse Malta 6.



Parlamenti ka rol në këto aktivitete tradicionale parlamentare:

- Krijimin e legjislaturës evropiane - rolin e ndan me Këshillin e ministrave;
- Zgjedhje dhe formim të pushtetit ekzekutiv - ky rol veçanërisht vërehet gjatë vërtetimit të Kryetarit të Komisionit Evropian dhe më vonë në të gjithë anëtarët e Komisionit Evropian dhe zgjedhja e Ombudsmanit ;
- Kontrolli demokratik i aktiviteteve të institucioneve dhe trupave tjerë të UE-së - kjo kompetencë i mundëson Parlamentit Evropian të parashtron pyetje deri te komisioni Evropian dhe të gjitha institucionet tjera të UE, si dhe obligim i institucioneve dhe vendeve -anëtare Evropiane të informojnë

Parlamentin për aktiviteteve të tyre, të drejtë të pranoj parashtesa të parashtruara nga qytetarët e UE-së dhe të tjera.

- Kompetencë buxhetore - së bashku me Këshillin e ministrave, merr pjesë në procedurën për votim dhe vërtetim të buxhetit të UE-së.

Puna e parlamentit Evropian zhvillohet në tre qytete: në Strasburg mbahen seancat plenare, në Bruksel punojnë komisionet parlamentare dhe grupet politike, kurse në Luksemburg gjendet Sekretariati i tij.

Në punën e tij Parlamenti i përdor të gjitha gjuhët zyrtare të Unionit.

PYETJE 1:

1. Sa gjuhë zyrtare ka në Union dhe cilat janë ato?
2. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e kësaj zgjidhjeje? Cila zgjidhje mendoni se do të ishte më e mirë?

Këshilli i ministrave

Këshilli i Ministrave është institucion kyç gjatë sjelljes së vendimeve në UE, së bashku me parlamentin Evropian. Siç asocionon edhe emri, në suaza të Këshillit çdo vend anëtar merr pjesë me nga një ministër. Cili ministër nga secili vend-anëtar do të merr pjesë në punë varet nga pyetjet që diskutohen në mbledhjen e ministrave (për shembull nëse diskutohet rreth rrjetave transportuese, do të marrin pjesë ministrat për transport, kurse nëse diskutohet për vizë dhe azil, do të marrin pjesë ministrat për drejtësi ose për punë të brendshme).

Përmes anëtarëve të Këshillit barten dhe përfaqësohen interesat nacionale të vendeve anëtare.

Kompetencat e Këshillit janë në pjesëmarrjen gjatë vendosjes së vendimeve, koordinimi i politikave nacionale të anëtarëve dhe informim i përbashkët mes anëtarëve. Këshilli i Ministrave selinë e ka në Bruksel.

- Detyrat kyçe të Këshillit janë që:
- të krijoj legjislaturë evropiane;
- të kërkoj nga Komisioni Evropian të paraqes propozim për sjelljen e legjislaturës së re;

- të sjell buxhet- kompetencë që e ndan me Parlamentin;
- të propozoj emërimet dhe të emëroj, për shembull kryetarin dhe anëtarët e Komisionit, anëtarët e gjyqit Evropian të revizorëve, anëtarët e Këshillit zgjedhor të bankës qendrore Evropiane, si dhe anëtarët e disa komiteteve të UE-së;
- mundëson koordinim në lëmin e politikës ekonomike dhe politikës së punësimit;
- i jep mandat Komisionit për negociata dhe arritjen e marrëveshjeve të caktuara me vende që nuk janë anëtare të UE-së, si dhe organizata ndërkombëtare.

Kryesia e Këshillit të ministrave ndërrohet çdo 6 muaj në bazë të rotacionit dhe secili vend-anëtar ka mundësinë që 6 muaj të jetë kryesues. Kryesia me Këshillin nënkupton role të rëndësishme: inicim të propozimeve për punën e Këshillit, koordinim dhe udhëheqje të punës së saj dhe përfaqësimin e Këshillit në lëmi ndërkombëtare dhe në Union.

Cili ministër nga secili vend-anëtar do të merr pjesë në punë, varet nga pyetjet që diskutohen në mbledhjen e ministrave (për shembull nëse diskutohet rreth rrjetave transportuese, do të marrin pjesë ministrat për transport, kurse nëse diskutohet për vizë dhe azil, do të marrin pjesë ministrat për drejtësi ose për punë të brendshme).



PYETJE 2:

1. A e dini cili shtet në këtë moment përfaqëson Këshillin e ministrave?
2. Pse është kjo me rëndësi?

Komisioni Evropian

Komisioni paraqet forcë lëvizëse për euro-integrimin. Ai i përfaqëson dhe i mbrohet interesat e përbashkëta të bashkësisë, për atë është i njohur edhe si "mbrojtës i marrëveshjeve". Atë e përbëjnë 27 komisar, nga një të propozuar nga secili vend-anëtar i propozuar nga Këshilli dhe Parlamenti. Secili nga komisarët e Komisionit Evropian është përgjegjës për njërin nga sektorët të Komisionit (për shembull zgjerimi, transporti, ambienti jetësor etj.) dhe ka mandat 5 vjeçar.

Roli i Komisionit është i ngjashëm me rolin që e ka qeveria në një shtet. Komisioni ka të drejtë të iniciojë sjellje të ligjeve në UE dhe e mbikëqyr implementimin e legjislaturës së UE-së në shtetet anëtare. Komisioni është bartës i implementimit të politikave të UE-së dhe e udhëheq buxhetin e UE-së. Ai e përfaqëson Unionin Evropian në politikën e jashtme dhe bën negociata gjatë vendosjes së marrëveshjeve ndërkombëtare. Komisioni Evropian gjithashtu ka të drejtë përfaqësie edhe në vende të cilat nuk janë anëtare të UE-së.



PYETJE 3:

1. A e dini kush është në këtë moment përfaqësuesi i Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë?
2. A e dini ku gjendet Delegacioni i Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë?
3. A dini të cekni ndonjë aktivitet të cilin e udhëheq ose në të cilin është kyçur Delegacioni i Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë?

Gjyqi Evropian i drejtësisë

Nëse në Union i përcaktuar bartësit e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, është normale të presim edhe institucion që është bartës i pushtetit gjyqësor, dhe ai është pikërisht Gjyqi i drejtësisë. E përbëjnë 27 gjykatës, nga një prej secilit vend anëtar, të zgjedhur në pajtueshmëri të gjithë anëtarëve, me mandat 6 vjeçar.

Ky gjyq është kompetent vetëm për pyetje që përfshin legjislaturën evropiane. Kështu, ai vepron në rastet në vijim:

- e shpjegon të drejtën evropiane (i shpjegon përgjegjësit dhe të drejtat e institucioneve evropiane, të shteteve anëtare, të personave fizik dhe juridik në pajtim me atë drejtësi)
- vendos nëse shtetet anëtare i përmbushin detyrat në pajtim me drejtësinë e Unionit;

- i asgjëson aktet juridike të cilat nuk janë në pajtim me të drejtën evropiane; Të shprehurit në Gjyqin Evropian të drejtësisë mund të realizohet në cilëndo gjuhë zyrtare të

Unionit, me çka ajo gjuhë bëhet “gjuhë e rastit”. Por gjykatësit në këtë gjyq më së shpeshti diskutojnë në gjuhën frënge.

Secili nga komisarët e Komisionit Evropian është përgjegjës për njërin nga sektorët të Komisionit (për shembull zgjerimi, transporti, ambienti jetësor etj.) dhe ka mandat 5 vjeçar.

Gjyqi Evropian i revizorëve

Gjyqi Evropian i revizorëve është institucion i themeluar në vitin 1975, me seli në Luksemburg. Ai është i përbërë nga një anëtar nga secili vend anëtar në UE. Mandati i anëtarëve është 6 vjet, kurse ata emërohen në marrëveshje mes vendeve-anëtare, në konsultim të Parlamentit Evropian. Gjyqi Evropian i revizorëve ka për detyrë të siguroj se të gjitha të ardhurat në UE janë të mbledhura dhe se harxhimet janë bërë në mënyrë të ligjshme dhe me plan. Revizorët, mund të bëjnë revizion të cilitdo institucion, trup, organ nacional, person fizik apo juridik që posedon para të UE-së, dhe nëse është e nevojshme të dërgojnë raste deri te Gjyqi i drejtësisë.

PYETJE 4:

1. A ka Republika e Maqedonisë institucion që kujdeset si harxhohen të hollat buxhetore?

SJELLJA E VENDIMEVE NË UNIONIN EVROPIAN

Organizimi i punës në Unionin Evropian është i ndërlikuar për tu kuptuar dhe shumë hulumtime tregojnë se një numër i madh i qytetarëve të vendeve - anëtare të Unionit nuk e kuptojnë mënyrën në të cilën punon Unioni. Pse atëherë të rinjtë nga Maqedonia të mundohen ti kuptojnë

këto procedura të komplikuara? Pasi që për të qenë qytetar i mirë evropian, nuk do të thotë vetëm të pranohen vlerat nga të cilat buron Unioni, por edhe të njihet mënyra e punës së të njëjtës, në veçanti në suaza të sjelljes së vendimeve.

Si sjell "ligje" Unioni Evropian?

Komisioni Evropian propozon "ligje" të reja, por të njëjtat i sjell Këshilli i ministrave dhe Parlamenti. Me nocionin "ligj" ose legjislaturë të Unionit nënkuptohen llojet e akteve në vijim:

- **rregulloret** - që vlejnë njëlloj për të gjithë anëtarët, menjëherë pas përvetësimit të tyre. Ato zbatohen drejtpërdrejt, pa pasur nevojë vendi anëtar ta zhyt në ligjet e saj të brendshme;
- **direktivat** - paraqesin rezultate obliguese që vendet - anëtare duhet ti arrijnë, por në arritjen e tyre kanë liri

të zgjedhin mënyra dhe mjete për veprim (mund të jenë për të gjithë ose vetëm disa vende -anëtarë);



- **vendime** - janë në lidhje me pyetje specifike dhe janë obliguese për vendet -anëtare, institucione, persona juridik ose fizik të cilëve iu drejtohen.

Në UE sillen edhe **rekomandime** dhe **mendime** që nuk kanë ndikim obligues dhe me atë nuk bëjnë

pjesë në radhën e “ligjeve” që i sjell Unioni, por e përfaqësojnë qëndrimin e institucionit të veçantë në UE, në lidhje me ndonjë pyetje.

SHEMBULLI 1.

Në nëntor të vitit 2005 Komisioni Evropian solli rekomandim deri te Këshilli Evropian, që Republikës së Maqedonisë ti jepet statusi kandidat për anëtarësim në Unionin. Këshilli i ministrave nuk ishte i obliguar që ta ndjek këtë rekomandim.

A e dini si vendosi këshilli Evropian për këtë rekomandimi?

Të gjitha këto akte shpallen në **Gazetën zyrtare të Unionit**, në të gjitha gjuhët zyrtare të Unionit. Faqja e internetit në gjuhën angleze e Gazetës zyrtare të UE-së është: <http://eur-lex.europa.eu/en/index.htm>

Rregullat dhe procedurat për sjelljen e vendimeve janë të vendosura në 4 marrëveshjet nga të cilat niset UE. Çdo akt juridik evropian themelohet nga neni i caktuar nga këto marrëveshje, dhe ai nen konsiderohet si themel juridik për aktin.

Unioni mundet të vepron vetën në suaza të autorizimeve që dalin nga Marrëveshjet, për të cilat janë pajtuar vendet-anëtare. Institucionet e UE-së nuk mund të sjellin “ligje” në lëmit në të cilat nuk është saktësisht e cekur ne marrëveshje se është përgjegjësi e Unionit.

Ekzistojnë tre procedura për sjelljen e ligjeve: Procedurat dallohen sipas mënyrës së bashkëpunimit të institucioneve të cilat janë bartës të procesit legjislativ, Këshilli i ministrave dhe parlamenti Evropian, e posaçërisht varet nga fuqia e Parlamentit të ndikoj në rezultatet nga vendimet:

- **Konsultim** - Parlamenti është i konsultuar (jep mendimin e tij), ndërsa Këshilli i ministrave e sjell vendimin duke e pasur parasysh mendimin e Parlamentit, por pa pasur obligim ta respektoj të njëjtën.
- **Pajtim** - Këshilli i ministrave sjell vendim pas marrjes së pajtimit nga Parlamenti.

Unioni mund të ndikon vetëm në kornizat e autorizimeve që dalin nga Kontrata, për të cilën janë pajtuar shtetet-anëtare. Institucionet e EU-së nuk mundin të sjellin “ligje” në fushat për të cilat në kontratat nuk është përcaktuar në mënyrë qartë se janë nën kompetenca të Unionit.

- **Bashkë-vendim** – Parlamenti dhe Këshilli i ministrave kane rol të njëjtë në sjelljen e vendimit. Cila nga këto tre procedura do të përdoret, varet nga pyetja të cilës i drejtohet akti (zgjerimi i Unionit, lidhje transportuese, politika sociale).

Procedura e konsultimit

Gjatë procedurës së konsultimit, Komisioni e dorëzon propozimin e tij deri te Këshilli i ministrave dhe deri te Parlamenti. Por, Këshilli i ministrave është ai i cili zyrtarisht e konsulton (kërkon mendime për propozimin) Parlamentin, por edhe trupa të tjerë të Unionit. Këshilli i ministrave e ka për obligim mendimet e të gjithë institucioneve ti merr parasysh gjatë sjelljes së vendimit, por nuk ka obligim t’iu bashkëngjitet të njëjtave.

Këshilli i ministrave, pas marrjes së mendimit nga Parlamenti, gjithashtu vendos për atë a do ta pranon, refuzon, ose ndryshon propozimin e Komisioni.

Konsultimi përdoret, për shembull, në revizionin e çmimeve në bujqësi, caktimit e ndonjë urdhri në lidhje me qytetarët e UE-së, ose lidhur me azilin dhe migracionin.

Procedura e pajtimit

Në procedurën sjellja e vendimeve me pajtim, Këshilli para se të sjell vendim, patjetër duhet të merr pajtim për të njëjtën nga Parlamenti.

Për dallim nga procedura e paraprake, gjatë procedurës së pajtimit, Parlamenti para vetes ka vetëm dy mundësi - ose të pranon në tërësi propozimin nga Komisioni, ose të njëjtin në tërësi ta refuzon. Nëse Parlamenti nuk jep pajtim për

propozimin e Komisionit, Këshilli i ministrave nuk mund ta sjell të njëjtin.

Nëpërmes procedurës së pajtimit sillen akte të cilat, për shembull, ju drejtohen bankës Qendrore të Unionit, fondeve strukturale dhe kohezive ose gjatë pranimit të vendeve të reja anëtare.



PYETJE 1

Pse kjo procedurë është e rëndësishme për Republikën e Maqedonisë?
A imponon edhe aktivitete tjera në ndonjë nga organet në pushtet?

Procedura e bashkë-vendimit

Nëse procedurat e deritanishme në kuadër të UE-së dukeshin të ndërlikuara, procedura e bashkë-vendimit është definitivisht kulmi i ndërlikimit të njëjtave. Sipas kësaj procedure, Parlamenti dhe Këshilli i ministrave kanë autorizime ligjdhënëse të barabarta dhe plotësisht të ndara dhe të barabarta si dhe mundësi për ndikim ndaj akteve juridike të sjellura.

Në procedurën e bashkë-vendimit, Komisioni e dërgon propozimin edhe në Këshillin i ministrave dhe në Parlamentin, dhe secila nga këto dy institucione kanë mundësin ta pranojnë në dy shikime që ndodhin njëra pas tjetrës. Nëse ndonjëra nga këto institucione bën ndryshim në aktin juridik, ai ndryshim patjetër duhet plotësisht të pranohet nga institucioni tjetër, që akti të sillet. Nëse Këshilli dhe Parlamenti nuk mund të pajtohen për tekstin e aktit, propozimi shkon para "Komitetit për pajtueshmëri" që është i përbërë nga numër i njëjtë përfaqësuesish nga të dy institucionet. Në komitet marrin pjesë

edhe përfaqësues të Komisionit që mund të japin sqarime plotësuese për një pjesë të zgjedhjeve të propozuara, nëse kërkohet nga ata.

Pasi që Komiteti të arrij pajtueshmëri, teksti kthehet në rishikimin e tretë-fundit të mundshëm para Këshillit dhe Parlamentit, të cilët ose tërësisht e pranojnë, ose e refuzojnë propozimin e Komisionit.

Përmes procedurës të bashkë-vendimit sillen aktet më të mëdha juridike, si për shembull, akte që kanë të bëjnë me tregun e përbashkët, të drejtat e punëtorëve- emigrantëve ose mbrojtje e konsumuesve. Tendenca në Union është që të rritet numri i llojit të pyetjeve që do të zgjidhen me këtë procedurë, me qëllim që të mundësohet pjesëmarrje e njëjtë në sjelljen e vendimeve e Këshillit të ministrave- si përfaqësues i interesave të shteteve-anëtare dhe të parlamentit Evropian- si përfaqësues i të gjithë qytetarëve të Unionit.

MAQEDONIA DHE UNIONI EVROPIAN

Fillimet e asaj që sot e njohim si Union Evropian shihen në vitin 1950 dhe i karakterizon bashkimi i gjashtë shteteve: Franca, Gjermania, Italia, Belgjika, Holanda, dhe Luksemburgu. Sot, 50 vjet më vonë, Unionin e përbëjnë 27 anëtare.

Domethënë, anëtarët e Unionit janë qartë të përcaktuar që të jenë të hapur të pranojnë në anëtarësim edhe shtetet tjera evropiane, duke arritur bashkim të plotë të kontinentit evropian. Por, si bëhet zgjerimi? A ka kritere dhe procese të caktuara? A mundet secili shtet të jetë anëtar në Union? Dhe në fund, cilën rrugë e kaloi Republika e Maqedonisë në mundimet e saja për anëtarësim dhe cila rrugë e pret?

Si bëhet anëtare e Unionit Evropian?

UE është i hapur për secilin shtet Evropian që i respekton principet e lirisë, demokracisë, të drejtat dhe liritë elementare të njeriut dhe qeverisjes së drejtësisë.

Ky parakusht themelor për paraqitje për anëtarësim në Union është i shpjeguar më me detaje në takimin e kryetarëve të shteteve dhe qeverive e mbajtur në vitin 1993 në Kopenhagën, ku u vërtetuan edhe kriteret themelore për anëtarësim në Union. Këto kritere i njihni si kritere të Kopenhagës, kurse ata kërkojnë që para se të bëhen anëtare të plota, shtetet - kandidatë të:

- të kenë institucione qëndrueshme që garantojnë demokracinë, sundimin e drejtësisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtat e pakicave;
- ekonomi funksionale të tregut, me kapacitet që ta përballon konkurrencën e fuqive tregtare në UE;
- aftësi që të përmbushen obligimet e anëtarësimi, si dhe pranim dhe plotësim të qëllimeve të unionit politik, monetar dhe ekonomik;

Njëkohësisht, shteti-kandidat duhet të ketë kapacitet funksional, administrativ dhe gjyqësor për realizimin e përgjegjësive të mara nga anëtarësimi në Union.





PYETJE 1:

1. Diskutoni secilin kriter në veçanti dhe përcaktoni të gjitha institucionet që duhet vazhdimisht ta përsosin punën dhe kapacitetin e tyre që të plotësohen kriteret e Kopenhagës.

Si u zhvilluan marrëdhëniet mes Maqedonisë dhe Unionit Evropian - Hapat kyçe drejt Unionit Evropian

Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian paraqet interes strategjik dhe qëllim me prioritet për Republikën e Maqedonisë, që nga momenti i pavarësimit në vitin 1991.

Marrëdhëniet mes Maqedonisë dhe Unionit filluan të zhvillohen në vitin 1992, kur vendi ynë dërgoi përfaqësues në Bruksel. Në vitin 1995, Republika e Maqedonisë dhe Unioni vendosën marrëdhënie diplomatike dhe u hapën negociatat për nënshkrimin e më shumë marrëveshjeve. Në vitin 1998, hyri në fuqi Marrëveshja për

bashkëpunim, si marrëveshje më e rëndësishme para nënshkrimit të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociacion (MSA).

MSA u nënshkrua në vitin 2001 dhe në të ishte qartë e përcaktuar që Republika e Maqedonisë ka ardhmëri si anëtare e Unionit Evropian, nëse i plotëson kushtet e nevojshme për atë.

Si u bë Maqedonia vend-kandidat për anëtarësim në Unionin Evropian?

Më 22 mars të vitit 2004 në Dublin, Republika e Irlandës, Republika e Maqedonisë dorëzoi aplikacion për anëtarësim në UE. Gjashtë muaj më vonë, Republika e Maqedonisë e filloi procedurën për përgjigjen e pyetësorit që i ishte dërguar nga komisioni Evropian, si mjet përmes të cilit thellësisht skanohet gjendja e tërësishme e vendit- aplikues për anëtarësim në Unionin Evropian.

Deri më 31 janar të vitit 2005, institucionet maqedonase i përgatitën përgjigjet në të cilat realisht e prezantuan gjendjen, por edhe planet me afate për përmirësim në secilin prej sektorëve specifik në shoqëri. Pas analizës së përgjigjeve, Komisioni Evropian përgatiti mendim me të cilin i rekomandoi Këshillit Evropian që Republikës së Maqedonisë ti jepet statusi kandidat.

Më 17 dhjetor të vitit 2005, Këshilli evropian Republikës së Maqedonisë i ndau status të vendit - kandidat për anëtarësim në UE. Kryetarët e shteteve dhe të qeverive të vendeve - anëtare

të UE-së, në këtë mënyrë i dhanë shpërblim për përparimin që Maqedonia e bëri në plotësimin e kriterëve të Kopenhagës.

Çdo të thotë statusi-kandidat për shtetin?

Në bazë të statusit-kandidat për anëtarësim në Unionin Evropian, Republika e Maqedonisë mund të shfrytëzon ndihmë për zhvillimin e shoqërisë nga më shumë fonde se sa që ishte rasti më parë (këto fonde me një fjalë do të jenë të njohura si IPA - Instrument për ndihmë para qasjes). Statusi kandidat njëkohësisht u mundëson përfaqësuesve të Maqedonisë (më shpesh ministër nga lëmi të ndryshme) të marrin pjesë në disa mbledhje

me kolegët e tyre nga Unioni, në të cilat flitet për përmirësimin e bashkëpunimit në suaza të UE-së. Më në fund, statusi vend-kandidat do të thotë edhe bazë për fillim të negociatave për anëtarësim, me përfundimin e suksesshëm të cilëve Maqedonia do të bëhet anëtare e Unionit.

Cilat organe janë përgjegjëse për koordinimin e marrëdhënieve në mes Maqedonisë dhe Unionit Evropian?

Cilat organe janë përgjegjëse për koordinim të marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Unionit Evropian?

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë mbi 30 organe të ndryshme, trupa ose sektor që punojnë në euro-integrimin e shtetit. Më të rëndësishmet nga ato janë:

Në nivel të legjislaturës - Kuvendi i Republikës së Maqedonisë:

- Komiteti për pyetje evropiane
- Këshilli nacional për euro-integrim


Në nivel ekzekutiv - Qeveria e Republikës së Maqedonisë:

- Komiteti për integrim euroatlantik
- Zëvendës - kryetari i Qeverisë për integrim evropian
- Ministri për punë të jashtme

Në nivel administrativ

- Sekretariati për çështje evropiane
- Ministria për punë të jashtme
- Sektorët për integrim evropian në ministritë

Më poshtë është dhënë pamje më e rëndomtë i më të rëndësishmëve nga ata.



Komiteti për integrim euroatlantik është institucion qendror për koordinim politik të procesit të euro-integrimit të Maqedonisë. Komitetin e përbëjnë Kryetari i Qeverisë- si kryesues, zëvendës-ministrat e Qeverisë, ministrat për: punë të jashtme; financa; mbrojtje;

punë të mbrëmshme; drejtësi; ekonomi; bujqësi; ambient jetësor; transport dhe lidhje. Me bazë të ftesës nga na e Kryetarit të Qeverisë, në punën e Komitetit mund të marrin pjesë edhe persona tjerë.

Komiteti punues për integrim evropian nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë është trup operativ ndërmësor me të cilin e udhëheq zëvendës kryetari i Qeverisë i obliguar për çështje evropiane, kurse anëtarët e tij janë të gjithë sekretarët shtetëror nga ministrinë. Ky komitet i cakton metodat dhe dinamikën për realizimin të strategjive dhe vendimeve, drejtimet politike dhe prioritetet e Qeverisë, në të njëjtën kohë bën edhe kontrollin e realizimit të detyrave konkrete.

Sekretariati për çështje evropiane gjithashtu ka funksion koordinues si Komiteti i lartpërmendur, por në aspektin administrativ për euro-integrim. Sekretariati ka për detyrë të drejton procesin e integritit evropian në organet e administratës shtetërore, si dhe të siguron përkrahje të ndihmës së huaj të cilin e fiton shteti.

Ministria për punë të jashtme është e obliguar për mirëmbajtjen e marrëdhënieve mes Republikës së Maqedonisë me UE, para së gjithash përmes Misionit të Republikës së Maqedonisë në Bruksel, por edhe nëpërmjet të ambasadave që Maqedonia i ka në vendet-anëtare.

Sektorët për punë evropiane janë të formuara në të gjitha ministrinë dhe kanë rol të ngjashëm me atë të Sekretariatit për pyetje evropiane- ato janë lidhja themelore në koordinimin e aktiviteteve të euro-integritit në secilin ministri.

Komiteti për integrim evropian në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë i shqyrton propozim-ligjet, në aspekt të asaj se a janë në linjë me ligjet e Unionit Evropian.

Këshilli Nacional për euro-integrime në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë është i udhëhequr nga ana e opozitës dhe në të marrin pjesë jo vetëm deputetë, por edhe përfaqësues nga Qeveria, Kryetari, ASHAM, organizata joqeveritare. Ky Këshill paraqet forum më të gjerë në nivel nacional në të cilin diskutohen të gjitha pyetjet e rëndësishme për euro-integrim të Republikës së Maqedonisë.

Më shumë informacione për integrimin e Republikës së Maqedonisë në UE dhe për qëndrimin e Unionit në vendin tonë, mund të gjeni në internet- faqet e:

- **Sekretariatit për çështje evropiane** - www.sep.gov.mk
- **Zyra e delegacionit të Komisionit Evropian në Republikës e Maqedonisë** - www.delmkd.cec.eu.int
- **Komision evropian** në pjesën kushtuar Maqedonisë (informatat janë në gjuhën angleze) <http://ec.europa.eu/comm/enlargement/fyrom/index.htm>

Informata mund të merrni edhe në hapësirën e **Qendrës informative të UE-së** që gjendet në rr. "Mito Haxhivasiliev Jasmin" nr. 52b, në ndërtesën e zyrës së delegacionit (<http://www.euic.mk>) ose në cilëndo nga **pikat informative të UE-së** në Republikën e Maqedonisë::

Pika informative e UE-së në Kumanovë Komuna e Kumanovës

Qendra për informim të qytetarëve

Adresa: 11 Tetori panr.
1300 Kumanovë
Tel/fax: (++ 389 031) 437 310
e-mail: kumanovo@cig.org.mk

Pika informative e UE-së në Koçani Komuna e Kocanit

Qendra për informim të qytetarëve

Adresa: Rade Kratovqe nr. 1
2300 Kocani
Tel/fax: (++ 389 033) 274 045
e-mail: goce_S@mol.com.mk
lidijataseva@yahoo.com

Pika informative e UE-së në Manastir Komuna e Manastirit

Qendra për informim të qytetarëve

Adresa: Bul. 1 Maj panr.
7000 Manastir
Tel/fax: (++ 389 047) 232 800
e-mail: bitola@cig.org.mk
vnalevska@yahoo.com

Pika informative e UE-së në Kavadar Komuna e Kavadarit

Adresa: Marshal Tito panr.
1430 Kavadar
Tel/fax: (++ 389 043) 400 022
e-mail: efremov24@yahoo.com
kavadarci@cig.org.mk

Pika informative e UE-së në Gostivar Komuna e Gostivarit

Qendra për informim të qytetarëve


Adresa: Bul.Vëllezërit Gjnovski nr. 61
1230 Gostivar
Tel/fax: (++ 389 042) 218 167
e-mail: gostivar@cig.org.mk

Pika informative e UE-së në Tetovë Komuna e Tetovës

Adresa: rr. JNA panr.
1200 Tetovë
Tel/fax: (++ 389 044) 337 910
e-mail: tetovo@cig.org.mk
neritanus@yahoo.com

Pika informative e UE-së në Veles Komuna e Velesit

Adresa: rr. Panko Brashnar nr.1
1400 Veles
Tel: (++ 389 043) 231 241
e-mail: itc_ve@mt.net.mk
veles@cig.org.mk



PROGRAME TË BASHKËSISË

Një nga instrumentet me të cilat Unioni Evropian do ta plotëson Agjendën e re të Lisbonës janë edhe programet e ashtuquajtura Programme të Bashkësisë. Kjo është një kupë me para të parapara për projekte të ndryshme të shteteve – anëtare, të cilat duhet të mundësojnë vazhdim të integritimit më të thellë në fusha të dhëna dhe të cilat me kalimin e kohës mund të përparojnë në politika të përbashkëta të UE-së. Për këtë arsye këto programe janë më shpesh të koncentruar në fusha të cilat shtetet anëtare i ruajnë për vete me xhelozë dhe nuk i hedhin kompetencat në nivel të UE-së, pasi janë shumë të ndjeshme (arsimimi, kultura, mediumet, te drejtat njerëzore e tj.), ose në fushat në të cilat integrimi nuk është i mjaftueshëm dhe mund të përmirësohet (doganat, taksimet, mbrojtja sociale, anti-diskriminimi e tjerë), ose në proceset në të cilat mund të zhvillohet politikë e përbashkët dhe nga rezultatet e tyre të niset procesi i krijimit të politikës (energji, nënshtetësia evropiane, qytetërimi aktiv e tjerë). Sidoqoftë shtetet – anëtare e kuptojnë që bashkëpunimi i ndërsjellët është shumë i rëndësishëm dhe prandaj në çdo shtet vjet me perspektivat e reja financiare kërkojnë nga Komisioni Evropian ti zhvillojë dhe realizojë këto programe.

Që të sigurohet përdorimi më i mirë i mjeteve të shpërndara në programet e ndryshme të Bashkësisë, Komisioni Evropian i thjeshtëson programet e përfshira me kornizën financiare 2007-2013. Në fakt tash ekzistojë programe kornizë të cilat bashkojnë disa programe nga korniza e mëparshme financiare, ashtu që vjen deri në unifikimin e rregullave. Për pamje më të mirë të programeve të cilat financiohen më herët dhe të atyre që parashikohen për periudhën 2007-2013, mund të shihni tabelën e cila pason në vazhdim.

Duke marr parasysh që këta programe janë të financuara nga buxheti i UE-së, kurse buxhetin e mbushin qytetarët e shteteve- anëtare, të drejta shfrytëzimi të këtyre mjeteve kanë qytetarët e UE-së. Por, politika e zgjerimit nënkupton që një ditë shtetet që kanë status shtet- kandidat, siç që është Maqedonia, do të bëhen shtete anëtare të UE-së prandaj është me rëndësi qytetarët e këtyre shteteve të marrin pjesë në Programet e Bashkësisë, pasi në atë mënyre hyn në rrjetin e përbashkët të UE-së, por ndërtojnë edhe rrjetëzime të reja të cilat do të mundësojnë iniciimin e projekteve të përbashkëta.

Që të jetë fer pjesëmarrja e këtyre shteteve, Unioni Evropian kërkon pjesëmarrje financiare nga buxhetet e shteteve të interesuara, që do të jetë adekuate për programet konkrete. Kushtet, rregullat dhe aktet janë të njëjta sikur edhe për shtetet anëtare, kurse pjesëmarrja financiare për secilin program rregullohet me nënshkrim të Memorandumit për marrëveshje, me të cilin parashihen kushte të njëjta për kontroll dhe revizion financiar. Kjo pjesëmarrje financiare quhet pagesë “biletë hyrëse”, kurse vlera përcaktohet me Memorandumin për Marrëveshje, për çdo program në veçanti. Derisa nuk përdoren, paratë për biletën hyrëse nuk kthehen, prandaj shtetet, në këtë rast Republika e Maqedonisë, para se të zgjedhin programet në të cilat do të marrin pjesë duhet mirë të mendojnë atë se cilat organizata kanë kapacitet të tërheqin paratë në emër të projekteve (sidomos ata të cilat Maqedonia do ti paguan nga buxheti i saj), kurse jo programet të cilat duken më tërheqëse. Komisioni Evropian kupton që shtetet si Republika e Maqedonisë kanë mjete të kufizuara, prandaj na lejon që në fillim të shfrytëzohen mjetet e IPA-së për ko-financim

të biletave hyrëse. Ko-financimi ngadalë duhet të zvogëlohet, në afat të periudhës trevjeçare.

E drejta për pjesëmarrje të shteteve - kandidatë dhe të shteteve - kandidat potencial përcaktohet në nivel politik. Kjo ndodhi në nivel të Këshillit Evropian në Selanik, në qershor të vitit 2003, kur me UE-në kryesonte Republika e Greqisë. Atëherë më në fund u bë e qartë që shtetet nga Ballkani perëndimor do të mund të bëhen shtete anëtare të UE-së, kurse Greqia vërtetoi që Procesi për stabilizim dhe asociim do të jetë korniza për integrim me ç'rast i hapi Programet

në bashkësi, tvingun dhe TAEKS-in në Ballkanin perëndimor, si instrumente të reja që do ta përshpejtojnë përgatitjen e tyre për anëtarësim. Prandaj perspektiva evropiane për Ballkanin perëndimor në UE njihet edhe si Agjenda e Selanikut.

Në këtë broshurë janë të paraqitura Programet e bashkësisë që janë të parapara për të rinjtë dhe arsimimin.



Programet në kornizat e perspektivës financiare 2007-2013

Programet e mëparshme të Bashkësisë	Programet e reja kornizë 2007-2013	DG
Socrates: Comenius, Erasmus, Grundtvig, Lingua, eLearning Leonardo da Vinci Jean Monnet	LLL - Action programme in the field of lifelong learning	Education Culture
Youth	Youth in Action	Ed./Cult
Culture 2000	Culture	Ed./Cult
Media Plus Media Plus Development Media Plus Distribution, Promotion Media Plus Pilot Projects Media Training	Media 2007 1. Support upstream of audiovisual production 2. Support downstream of audiovisual production 3. Pilot projects	Education Culture
Active European Citizenship Programme Town Twinning Support to European projects for debates by NGOs Projects from associations and federations of European integration	Europe for Citizens 1. Active citizens for Europe 2. Active civil society for Europe 3. Together for Europe	Education Culture
Community incentive measures in the field of employment Combating discrimination Combating social exclusion Gender equality	PROGRESS - Programme for employment and Social Solidarity 1. Employment - Working conditions 2. Social protection and social inclusion 3. Anti-discrimination and diversity 4. Gender equality	Employment social affairs
Multiannual Programme for Enterprises (MAP) FP6 Research and Innovation, Life-Environment e-TEN, Modinis, e-Content Intelligent Energy Europe: SAVE, ALTENER, STEER	CIP - Competitiveness and Innovation Framework Programme 1. Entrepreneurship and Innovation Programme 2. ICT Policy Support Programme 3. Intelligent Energy-Europe Programme: SAVE, ALTENER, STEER	Enterprise Industry Energy
Daphne II Fundamental Rights Judicial Cooperation in Civil Matters Support to NGOs in 10 new Member States	Fundamental Rights and Justice 1. Fight against violence, Drug prevention and Information 2. Fundamental rights and citizenship 3. Civil Justice / Criminal Justice	Justice Freedom Security
European Refugee Fund INTI ARGO RETURN	Solidarity and Management of Migration Flow 1. European Refugee Fund 2. European Fund for integration of 3-country nationals 3. External Border Fund 4. European Return Fund	Justice Freedom Security

Programet e mëparshme të Bashkësisë	Programet e reja kornizë 2007-2013	DG
Preparatory Action in favour of victims of terrorist acts AGIS	Security and Safeguarding Liberties 1. Prevention, Preparedness & Consequence Management of Terrorism 2. Prevention of and Fight against Crime	Justice Freedom Security
LIFE III Life Nature General Mechanism for policy implementation Action programme European environmental NGOs Programme for sustainable urban development Forest focus	LIFE + 1. LIFE Nature and Biodiversity 2. LIFE Environment policy and governance 3. LIFE Information and Communication	Environ-ment
FP6 Food safety and health risks Genomics and biotechnology for health Information society technologies Nanotechnologies, materials, New production processes Sustainable development, global change, ecosystems, aeronautics Citizens and governance Aeronautics and space	FP7 - Cooperation 1. Health 2. Food, Agriculture and Biotechnology 3. Information and Communication Technologies 4. Nanosciences, Nanotechnologies, Materials, new production technologies 5. Energy 6. Environment (including climate change) 7. Transport (including Aeronautics) 8. Socio-economic sciences and humanities 9. Security and space FP7 - Ideas (Fundamental Research)	Research
Marie Curie Actions	FP7 - People 1. Initial training 2. Lifelong training 3. Industry academia 4. Scholarships for international research	Research
Research and Innovation Horizontal research SME Regions of knowledge Research infrastructures INCO Science and society	FP7 - Capacities 1. Research potential 2. Research for the benefit of SMEs 3. Regions of knowledge 4. Infrastructures 5. INCO 6. Science in society	Research

TË RINJTË NË AKSION 2007-2013

Ardhmëria e çdo shoqërie, duke përfshirë edhe atë evropiane, janë të rinjtë. Mu për këtë arsye Unioni Evropian e stimulon bashkëpunimin në mes të rinjve, iniciativat e tyre lokale, ju mundëson të udhëtojnë dhe ta njohin kulturën e llojllojshme të

Evropës. Për periudhën prej vitit 2007-2013 janë të siguruara 885 milion euro për programin "Të rinjtë në aksion", me shpresë që do të ndihmohet të plotësohen nevojat e të rinjve, edhe atë nëpërmjet pesë aksioneve që vijojnë:

Aksioni 1. Të rinjtë për Evropën (265,5 milion euro)

Ky aksion ofron mundësi të veçantë për të njoftuar grupe te njerëzve të rinj. Shkëmbimet kanë dimension pedagogjik joformal të mësuarit si dhe dimension të vlerave, kurse grupet i hulumtojnë temat e përbashkëta dhe mësojnë për kulturat e njëri tjetrit. Gjithashtu përkrahen projekte rinore

lokale, rajonale dhe nacionale, pastaj rrytëzohen organizata nga shtete të ndryshme. Për tu zmadhuar pjesëmarrja e të rinjve përkrahen projekte evropiane për ndërrim të ideve, përvojës, metodologjive, aktivitete lokale, regjionale dhe nacionale.

Aksioni 2. Vullnetarizmi Evropian (203,55 milion euro)

Me këtë aksion të rinjtë prej moshës 13 deri më 30 vjet mund të kalojnë deri 12 muaj në ndonjë shtet evropian, si vullnetar evropian për të ndihmuar

ndonjë projekt lokal me lëmi të gjerë veprimi: politikë sociale, ambient jetësor, art dhe kulturë, teknologji të reja dhe zhvillime, sport etj.

Aksioni 3. Të rinjtë në botë (53,1 milion euro)

Ky aksion përkrah projekte të rinjve me shtete të treta me qëllim të promovimit të shkëmbimit mes të rinjve, zhvillimit të partneriteteve dhe rrjeteve, me ç'rast theksi i veçantë i theksohet dialogut, mirëkuptimit dhe tolerancës së ndërsjellë,

vetëdijes interkulturore dhe solidaritetit, thyerjes së paragjykimeve dhe stereotipave, dhe kuptohet, zhvillimit të shoqërisë civile dhe forcimit të demokracisë. Ky aksion përfshin edhe shtete tjera nga Amerika Jugore, Afrika, Karaibet, Azinë etj.

Aksioni 4. Sisteme për përkrahje të rinjve (132,72 milion euro)

Ky aksion i zhvillon strukturat për përkrahje dhe rolin e atyre që punojnë me të rinj dhe me organizata rinore. Qëllimi është që të zhvillohen organizatat joqeveritare rinore evropiane/ndërkombëtare të cilat do të kontribuojnë për pjesëmarrje aktive të qytetarëve të rinj në

jetën publike dhe në shoqëri. Këtu bëjnë pjesë bashkëpunimet rinore në kuptimin më të gjerë të fjalës. Çdo vit caktohen prioritetet që do të financohen (2007 ishte viti evropian i mundësive të barabarta, kurse viti 2008 ishte viti i dialogut inter-kulturor).

Aksioni 5. Përkrahje të bashkëpunimit evropian të rinjve (35,4 milion euro)

Të rinjtë e më shumë shteteve kanë mundësi të përballen dhe të diskutojnë në tema të ndryshme, dhe gjatë kësaj të mësojnë diçka më shumë për njëri tjetrin. Nga kjo del që ky aksion i mbështet organizimet të një dialogu të strukturuar të pjesëmarrësve të ndryshëm, duke organizuar seminare me karakter nacional dhe trans-nacional dhe ndihmon në zhvillimin e politikave të rinjve. Të rinjtë nga Maqedonia kanë mundësi të jenë pjesë përbërëse e rinisë evropiane dhe të kontribuojnë në përmirësimin e jetës së tyre në suazat evropiane. Në qoftë se deri tani jemi udhëhequr nga motoja “Njihe atdheun që

ta duash më shumë”, tani e tutje kjo moto ka ndryshuar dhe thotë: “Njihe më mirë Evropën, që ta duash më shumë”.

Republika e Maqedonisë akoma nuk është e kyçur plotësisht në këtë program. Kusht për pjesëmarrje në këtë program është formimi i Agjencisë nacionale për programe evropiane dhe për arsim dhe mobilim. Ky Agjenci është formuar në vitin 2008, por ende nuk është i akredituar nga ana e UE-së me qëllim të kryerjes së funksionit të saj. Fillimisht akreditimi ishte paralajmëruar në vitin 2009, por tani flitet se një gjë e tillë do të ndodh në fillim të vitit 2010.

Rrëfimi mbi vullnetarët evropian në Maqedoni



INDRE ZDANČIUTE (Indre Zdančiūtė) nga Lituania është vullnetare në Republikën e Maqedonisë që nga viti 2008. Ajo ishte vullnetare në Qendrën e vullnetarëve në Shkup, dhe rrëfen: “personalisht mendoj që një nga fitimet e Lituanisë nga anëtarësimi në Unionin Evropian ishte pjesëmarrja në programin ERASMUS, nëpërmjet të cilit studiova një vit në Itali, ndërsa tani ndodhem në Maqedoni, përsëri përmes programit për vullnetarë të financuar nga Komisioni Evropian. Në anën tjetër kam arritur që ta përvetësoj më mirë gjuhën angleze, frënge dhe italiane, bile kam mësuar edhe disa fraza nga gjuha maqedonase. Ndjenja si Evropiane është e mrekullueshme, si dhe të keni më shumë miq ndërkombëtar!

MARGO RAJS (Margot Reis) nga Franca, është vullnetare në Maqedoni, që nga viti 2008. Edhe ajo është vullnetare në Qendrën në Shkup, e cila ndër të tjera thekson: “Është një arritje e madhe liria të studiohet dhe të jetohet në cilindo vend evropian. Pasi që jam vetëm 25 vjeçare, akoma nuk më kujtohen kontrollimet kufitare të cilët ekzistonin më në të kaluarën, kur udhëtoja me prindërit e mi në ndonjë vend fqinj. Unioni më dha mundësi ta zbuloj botën, të jem më të hapur në pranimin e kulturave të tjera. Gjatë qëndrimit tim njëvjeçar në Gjermani si studente, pata mundësi të zbuloj Maqedoninë, duke iu falënderuar programit për këmbime të vullnetarëve të mbështetur nga Komisioni Evropian. Momentalisht jetoj në Shkup bashkë me koleget e mi evropian nga Lituania, Letonia, Çekosllovakia, Portugalia, Spanja, bile edhe nga Islanda. Së bashku e zbulojmë dhe kënaqemi në Maqedoni, dhe njëkohësisht mësojmë diçka edhe më tepër për fqinjët evropian. Çdo ditë e më tepër mbetem e mahnitur nga begatia kulturore e Evropës, nga kjo pjesë e vogël tokë.



MËSIM I PËRJETSHËM 2007-2013

Shtetet anëtare vetë vendosin për sistemin arsimor, sepse arsimit është një nga çështjet më të ndjeshme të një shoqërie. Sidoqoftë Komisioni Evropian, në rolin e promotorit dhe mbështetësit të arsimit, iu ndihmon shteteve anëtare që ti përmbushin dhe ti kryejnë detyrat dhe obligimet e definuar paraprakisht me ndihmën e programit Mësim i përjetshëm. Sipas programit të punës, deri në vitin 2010 duhet të realizohen këto detyra.

1. Të mos rritet numri i nxënësve që largohen më herët nga shkolla për më tepër se 10%.
2. Të rritet numri i nxënësve që kanë kryer lëndët matematikë dhe teknologji për 15%, si dhe të zvogëlohet dallimi gjinor në këto lëndë.
3. 85% e të rinjve deri në moshën 22 vjeçare të kenë të kryer shkollimin e mesëm.

4. Të përgjysmohet numri i të rinjve nga moshën 15 vjeçare, të cilët tregojnë rezultate të dobëta në lexim, matematikë, dhe në shkencë.
5. Të arrihet një ngritje nga 12,5% në pjesëmarrjen e të rriturve në arsim për të rritur.

Motoja e programit Mësim i përjetshëm është "Asnjëherë nuk është vonë për të mësuar".

Qëllimi kryesor i këtij programi është të kontribuoj për zhvillimin e Unionit Evropian në një shoqëri të përparuar që mbështetet mbi themelet e diturisë, dhe me zhvillim ekonomik të përjetshëm dhe me një kohezion më të madh social. Ky program ka një buxhet prej 7 miliard euro dhe përfshin periudhën që nga viti 2000 deri në vitin 2013, dhe është e ndarë në katër nën programe, një program transversal, si dhe programi Zhan Mone.





Jan Amos Komenský (1592-1670), mësues çek, shkencëtar, edukator dhe shkrimtarë. Ka qenë peshkop protestant dhe është autorë i veprës “Didactica Magna”. Arrin të bëhet i njohur si “mësues i kombeve” dhe mund të konsiderohet si baba e arsimit modern. Andaj, ky program jo rastësisht e mban emrin e tij. Grupi qëllimor i këtij nën programi janë arsimit parashkollor dhe ai fillor, deri në shkollën e mesme, si dhe institucionet që ofrojnë një arsim të këtillë. Qëllimet kryesore të këtij nën programi janë:

1. Përfshirja e 3 milion nxënësve në aktivitete të përbashkëta arsimore, deri në fund të projektit.
2. Rritja e nivelit të njohurive tek të rinjtë dhe te edukatorët mbi laramanin kulturore evropiane.
3. Ndihmë të rinjve për të fituar shkathtësi për zhvillim personal, për punësime të ardhshme dhe për nënshtetësi aktive evropiane).

“Evropa me shkrim” është projekt që del nga shkollat partnere të Komenskit, i cili e thekson historinë e pasur evropiane, kulturën e saj, traditat përmes mësimit të grafikëve në vende publike në disa qytete evropiane. Në këtë projekt 3- vjeçar u kyçën katër shkolla për dizajn grafik. Përveç shkëmbimit të njohurive, erdhi edhe deri te ndërrimi i shumë kontakteve me institucione të ndryshme evropiane dhe krijimit të një ueb-faqeje shumë gjuhësore. Në këtë projekt janë të përfshirë Amsterdam, Praga, Madridi dhe Riga. Çdo vit grupe e nxënësish mësonin tema të veçanta. Tema e parë ishte “Qytetet me shkrim”. Çfarë tregojnë qytetet? Shënohen dhe analizohen grafikët informativ, mënyra se si promovohet identiteti, frazat poetike etj. Tema tjetër ishte “Personalitete dhe sende me shkrim”. Për këtë temë nxënësit i shënuan sendet mobile në qytetet, sendet e mëdha dhe të vogla, siç janë: brendet,

markat tregtare, automobilat, transportin publik, mobilet etj. Gjithashtu vëzhguan edhe kafshët në qytete, emrat e tyre, raca etj. Dhe përfundimisht, u vëzhguan edhe njerëzit- emrat e tyre, tatuazhet, markën e rrobave që e mbajë dhe paraqitjen e tyre fizike. Faza e fundit e projektit – Grafikët e përbashkët global dhe lokal- ishte sintezë e punës së kryer në dy vitet e mëparshëm, në të gjithë katër qytetet e përmendura. Identitetet lokale krahasoheshin me ato globale. Projekti i mundësoi çdo qyteti të përcakton identitetin e tij lokal. Notoheshin ndikimet mes qyteteve të ndryshme, kurse përmes studimeve krahasuese dhe analizës të informacioneve të mbledhura, nxënësit ishin të përgatitur të gjejnë identitetin grafik evropian.

Dimensioni evropian për mësuesit dhe nxënësit në shkolla gjithmonë ishte prezent. Ky projekt shumë mirë i punuar dukshëm e ngriti vetëdijen

për globalizimin dhe për integrimin e kulturës të rinjve në Evropë. Materialet si dhe përvoja e nxënësve dhe mësuesve mund të gjinden ne ueb-faqen e projektit www.written-europe.org.

Projekti është i prezantuar në konferenca, muze, asociacione dhe institucione dhe janë të organizuara disa ekspozita.

Leonardo Da Vinçi 1452-1519 Matematikan, shkencëtar, inxhinier, novator, skulptor, botanist, artist, muzikant dhe shkrimtar Italian. Shpesh herë është paraqitur si arketip i njeriut të renesancës. Konsiderohet si piktori më i madh i të gjitha kohërave dhe si njeriu me më shumë talente në botë. Prandaj nuk është e rastit që programi i dedikuar për arsim profesional, pa arsimin e lartë profesional të mbajë emrin e Leonardo Da Vinçit. Qëllimet e këtij programi janë:

1. deri në mbarim te programit të rritet numri i vendeve të punës praktike në ndërmarrjet deri në 80.000.
2. Sigurimi dhe përdorimi i shkathtësive dhe kualifikimeve për zhvillim personal.
3. Përmirësimi i kualitetit dhe novitete në arsimin profesional.
4. Gatishmëria tek njerëzit.



Zhvillim i modelit për orientim profesional
Projekti kishte për qëllim zhvillimin e një modeli të orientuarit profesional dhe sistem të drejtimit të nxënësve në pajtim me nevojat e tregut të punës. U përgatit një internet-sistem kompleks për zgjedhje të karrierës në nivel regjional, me ndihmën e partnerëve nga Irlanda dhe nga Hungaria, që sot është nacional. Modeli për orientim profesional

i mori parasysh nevojat e tregut të punës, u realizua edhe trajnim profesional adekuat. Në kushte të tilla, të rinjtë dhe më të moshuarit kishin mundësi të sjellin vendime konkrete për karrierën e tyre. Për bashkëpunim më efikas në mes këshilltarëve, pushtetit regjional dhe organizatat që merrnin pjesë në projektin, ishte e domosdoshme të trajnohen plotësisht. Qendrat

për punësim e realizuan projektin në 8 qendra rajone dhe në 11 institucione nikoqire në Irlandë. Këshilltarët për orientim profesional dhe pushteti nga lënda (18) kaluan nëpër përgatitje gjuhësore, kulturore dhe profesionale dhe u shkuan në visit

studim dyjavor në Irlandë. Pas vizitës studimore, qendra për punësim, së bashku me organizatat partnerë, përgatiti model kompleks profesional për orientim, i postuar në internet në www.epalya.hu dhe ai u bë nacional në prill të vitit 2005.



Erasmus I Roterdamit 1466-1536 Humanist holandez dhe teolog i kishës katolike. Ka udhëtuar në qendrat më të njohura të diturisë të asaj kohe, siç kanë qenë Parisi dhe Kembrixhi. Tërë pasurin e tij e la në Universitetin e Bazelit dhe me këtë u bë pionier i granteve të mobilizuara, që sot mbajnë emrin e tij. Nëpërmjet kësaj sigurohen grante për mobilitet të profesorëve/studentëve, për rrjetëzim dhe partneritetit në arsimin e lartë. Nga këtu dalin edhe qëllimet e këtij nën-programi. Që nga fillimi i programit, në aksionin për mobilim duhet të kyçen 3 milion pjesëmarrës individual. Përkrahje për realizimin e hapësirës evropiane për arsimin e lartë. Kontribut për arsimin e lartë dhe përparimin në arsimin profesional në drejtim të inovacioneve.

Nikollaj Severin Grundvigi 1783-1872 Mësues, shkrimtar, poet, filozof, historian, klerik dhe politikan danez. Ai është baba ideologjik i shkollës së mesme popullore, por ka ëndërruar për themelimin e një universiteti të madh nordik. Shkolla për jetë (Shkolla e mesme popullore) dhe Shkolla e pasionit (Universiteti) ishin dy shtyllat e programit të tij. Ai besonte shumë që universiteti duhet të aftëson studentët për pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Për këtë arsye ky program ofron grante arsim, mësim dhe projekte në arsim për të rritur dedikuar për trajnuesit dhe ata që mësojnë.

Qëllimet e këtij programi janë:

1. Deri në vitin 2013 duhet të ndihmohen mobilizimi i 7000 pjesëmarrësve të kyçur në programin për arsimim të rriturve
2. Tu përgjigjet sfidave në arsimin të popullatës së rritur evropiane.
3. Të përmirësohen diturit dhe shkathëtit e njerëzve të popullata e rritur.



Mësoni gjuhë të huaja së bashku me nipërit e juaj. Projekti i shfrytëzoi marrëdhëniet e afërta mes gjeneratave të gjysheve dhe gjyshërve me nipërit e tyre, me ç'rast ata motivoheshin që nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta të mësojnë gjuhë të ndryshme. Suksesi i veçantë u vërejt tek të rriturit, të cilët më parë asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të mësojnë gjuhë të huaja. Gjithashtu, u tregua se mësimi i gjuhëve të huaja mund të jetë argëtues dhe të kontribuoj për anashkalimin e stereotipave se gjuha mund të mësohet vetëm në moshë të re.

Në shumë shtete evropiane, përderisa prindërit janë në punë për fëmijët kujdesen gjyshet dhe gjyshërit. Ashtu është rasti me Bullgarinë, Greqinë, Italinë dhe Spanjën. Nga më të rriturit pritet jo vetëm të ndihmojnë gjatë aktiviteteve të përditshme në shtëpi, por edhe gjatë shkrimit të detyrave të shtëpisë. Kjo ishte një mundësi për motivimin e të rriturve që t'iu bashkëngjiten nipërve të tyre gjatë mësimin të gjuhëve të huaja. Për tu anashkaluar mosdëshira e tyre për të mësuar u zhvilluan aktivitete joformale për tërheqjen e vëmendjes së tyre. U përpiluan lojëra të ngjashme me ata që përdorën në mësim për

fëmijë të vegjël me të cilat përmirësohen aftësitë e të mbajturit mend. Këta lojëra ishin argëtuese dhe ndihmuan që të krijohet një atmosferë e relaksuar në klasë. Bërja e gabimeve asnjëherë nuk është e hijshme për të rriturit, dhe për atë qëllimin theksi u vendua në bazën mësimore të njohurisë së gjuhës dhe të zhvillimit të aftësive të pjesërishme për të folur. Më të rriturit kënaqeshin në aspektin social të mësuarit në klubet joformale me gjyshet dhe gjyshërit tjerë dhe treguan entuziazëm të madh në garat gjuhësore në tim

me nipat e tyre. Thuajse nuk ka tjetër projekt për promovim e gjuhëve të kësaj grupe të njerëzve, dhe për atë ky projekt tërhoqi interes ë madh dhe i njëjti është i dhënë si shembull në shumë ngjarje nëpër Evropë. Gjithashtu projekti ka një nivel hamendas të ruajtjes së njerëzve të rritur të kyçur në projekt, kështu që tani shumica paguajnë të shkojnë në kurs dhe më tutje ta mësojnë gjuhën. Më shume detale për këtë projekt mund të gjeni ne ueb-faqen e projekti: www.znanie-bg.org.

Krahas këtyre katër nën-programeve, arsimi i përjetshëm i përfshin edhe të ashtuquajturat programe transversale, që kanë si qëllim rritjen e kualitetit dhe transparencës në sistemet e arsimit, dhe të sistemeve për trajnime në shtetet anëtare dhe shteteve pjesëmarrëse në këto programe. Gjithashtu të siguroj bashkëpunim evropian në sektorët e përfshira ne dy ose më tepër programe.

Zhvillimi i shkathtësive për udhëheqje të ndërmarrjeve të rinjtë. Pol Brokmani nga këshilli lokal i Sautemptonit udhëtoi në vizitë njëjavore hulumtuese në Maltë. Qëllimi i vizitës ishte të mëson si zhvillohen shkathtësitë për udhëheqje të ndërmarrjeve tek të rinjtë dhe ti inspiron të fillojnë biznese personale. Programi përfshinte vizita të organizatave dhe shkollave lokale me qëllim që të sheh si zhvillohet kjo shkathtësi të rinjtë nga Malta. Gjatë kësaj vizite njëjavore Poli u njoftua me punën e inkubatorit "Kordin Business Incubation Centre" dhe e vizitoi kolegjin për art dhe teknologji në Maltë (Malta College of Arts Science and Technology), që të shef si zhvillohet interesi te te studentët e rinj për të filluar me ndërmarrje. Njëkohësisht e vizitoi

edhe korporacionin për punësim dhe trajnim të Maltës (Malta's Employment and Training Cooperation), ku funksionon një shemë që ofron ndihmë në formë të diturisë dhe shkathtësisë për personat e papunësuar që të mund të nisin biznes personal. Në programin u inkuadrua edhe vizita e Viktor Galeut, kryetari i Odës ekonomike në Maltë. Poli deklaroi: "takimi me ministrin ishte i pazëvendësueshëm dhe me këtë u rrumbullakua vizita ime në Maltë. Zotëri Galeu ishte shumë i hapur për diskutim dhe kishte prezantim të shkëlqyeshëm për mekanizmat për përgatitje të politikave dhe për interakcion të anëve të përfshira. Ai i palodhur përgjigjej në pyetjet e ndryshme, duke filluar nga pyetjet për strategji deri në aspektet konkrete të programit arsimor". Si

rezultat nga vizita studiuuese, Poli dizajnoi program për trajnim të ndërmarrësve për vetëpunësim për organizatën e tij në Sautempton. Po ashtu idenë për biznes inkubator e parashtrori para Këshillit

të komunës së Sautemptonit. Eksperiencia e Polit ishte e financuar nga Programi Transversal i UE-së për vizita studiuuese.

Programi Zhan Mone është një iniciativë e Komisionit Evropian për nxitje të ligjëratave, hulumtimeve dhe kontributit kah të ashtuquajturën Studime euro-integruese në institucionet e arsimit të lartë. Ky program përfshin: Zhan Mone - Rrjet i qendrave evropiane të përkryera (European Centres of Excellence) - institucione universitare evropiane të pranuar nga ana e Komisionit Evropian për kërkime të kualitetit të lartë dhe ligjërata në temë: "Integrimet evropiane". Sot në gjithë botën funksionojnë 97 qendra të këtilla. Komisioni evropian i mbështet edhe katedrat Zhan Mone, si dhe modulet studimore Zhan Mone. Nëpër botë momentalisht ekzistojnë 629 katedra të këtilla.

Republika e Maqedonisë akoma nuk është kyçur në programin "Mësim i përjetshëm". Kusht për pjesëmarrje është formimin i Agjencisë nacionale për arsim dhe mobilim. Këtu bëhet fjalë për të njëjtën agjenci e përmendur në programin "Të rinjtë në aksion". Agjencia nacionale është formuar në vitin 2008 dhe ende nuk ka arritur të akreditohet nga UE për ta kryer funksionin e tij. Akreditimi ishte paralajmëruar së do të ndodhte në vitin 2009, por tani flitet se kjo do të ndodh në fillim të vitit 2010.

Me shpresë që një ditë edhe shteti ynë do të kyçet shumë shpejtë në programin Mësim i përjetshëm, qendra maqedonase për arsim evropian ka marrë për të drejtë të përpilon rrëfimin maqedonas, përmes së cilës do të paraqiten të gjitha të mirat që ua ofron programi qytetarëve të këtij shteti. Rrëfimi, tani për tani është i paramenduar, por shumë lehtë mund të bëhet realitet.

RRËFIMI NGA MAQEDONIA

Familja Stojanovski është një familje tipike maqedonase. Nëna Stojanka punon në një çerdhe, kurse Stojani është profesor universitar, vajza e tyre Stojna ndjek studimet humanitare në një nga universitetet në Maqedoni, ndërsa djali i tyre Stole vetëm sa ka mbaruar shkollimin e mesëm profesional (hotelieri) dhe momentalisht shqyrton mundësinë për hapje të një lokali privat i cili do të ofrojë specialitete të ndryshme të popujve që jetojnë në Unionin Evropian.

Në lagjen ku jetojnë familja Stojanovski para ca kohe janë vendosur disa familje hungareze, të cilët punojnë në Telekomunikacion e Maqedonisë. Ata janë kryesisht çiftet e reja që kanë nga dy fëmijë të moshës dy deri me katër vjet. Çerdhja në të cilën punon Stojanka nuk është në gjendje t'ua ofrojë shërbimet e saj këtyre familjeve, pasi asnjëri nga personeli nuk e njeh mirë kulturën dhe traditat hungareze, as që kanë njohuri themelore nga gjuha hungareze që është kusht themelor, por edhe i domosdoshëm për komunikim themelor me fëmijët. Për fat të mirë këto familje janë mirë të njoftuara me mundësitë që ofroni programi "Mësim i përjetshëm" dhe ata i ndihmuan drejtorisë që të kontakton me entet parashkollore në Hungari. Tani Stojanka ka filluar të mësoj hungarisht (e paguar nga pjesë e programit dedikuar për mësim të gjuhëve), drejtoresha e saj organizon projekte të përbashkëta me rrjetin e çerdheve në Hungari me ç'rast organizohen shkëmbime të personelit me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit (e paguar nga pjesë e programit COMENIUS), kurse Maqedonia me sukses promovohet në Hungari.

Stojanka i përcjell përvojat e saj të fituara tek burri i saj Stojani, i cili duke iu falënderuar

lidhjeve të saj me hungarezët ka arritur të vendos kontakte me disa universitete në Hungari. Duke i shfrytëzuar grantet për mobilim nga programi ERASMUS, Stojani qëndroi disa muaj në njërin nga universitetet hungareze dhe përvojat e fituara atje i kaloi në universitetin e tij në Maqedoni. Tani studentët e Universitetit të tij kalojnë nga disa muaj në studime në Hungari, harxhimet e tyre i mbulon UE në formë të bursave.

I mësuar nga përvoja e babait të saj, e bija Stojna është në fund të studimeve të saja dhe veç më ka aplikuar për studimet pasuniversitare e në universitetin i cili është pjesë e rrjetit ERASMUS në Gjermani. Studimet e saja do të realizohen në Gjermani, Finlandë dhe në Spanjë, me ç'rast do të vijojë kurse përgatitëse në gjuhën gjermane, finlandeze dhe spanjolle. Harxhimet për studimin e saj do të mbulojë UE.

Programi Mësim i përjetshëm ia hapi dyert edhe Stoles. Hapja e restorantit u tregua më e komplikuar se sa që priste. Ai u ballafaqua me dy probleme të mëdha: së pari, e kuptoi që nuk dinte asgjë për punën afariste, marketingun dhe që nuk di të bëjë një plan biznesi, dhe e dyta, erdhi në përfundim se kuzhinat evropiane janë të shumëllojshme dhe se përveç për shtetet e njohura fqinje, ai nuk din pothuajse aspak për atë së ç'far ushqimi kanë Danezët, Irlandezët, Lituanezët, Letonezët etj. Duke iu falënderuar programit GRUNDTVIG, Stole u regjistrua në kurs për planifikim afarist, menaxhim financiar dhe marketing në njërin nga qendrat për arsim të rinjve, kurse lidhjet e prindërve i ndihmuan për të lidhur kontakte me Shkollën e mesme hotelierike në Budapest, ku mësohen lëndë të veçanta

për kuzhinat Evropiane. Stole i lidhi dy shkollat dhe shkolla në Maqedoni punon në sjelljes e lëndës Kuzhinat Evropiane, pasi qe kolegët e tyre hungarez e morën përsipër t'iu ndihmojnë gjatë përgatitjes së programit mësimor si dhe në kualifikimin e kuadrit mësimor në Maqedoni.

Gjeneratat e ardhshme të nxënësve nga Maqedonia do të mund të qëndrojnë në Hungari, kurse nxënësit e shkollave të mesme hungareze do të mund ta mësojnë kuzhinën maqedonase këtu në Maqedoni. Harxhimet për këto hapa do të mbulohen nga programi LEONARDO DA VINCI.



Struktura e programit Mësim i përrjetshëm i UE-së duket kështu :

MËSIM I PËRJETSHËM 2007-2013 (6,970 miliard euro)

COMENIUS	ERASMUS (370 milion € në vit)	LEONARDO DA VINCI (215 milion € në vit)	GRUNDTVIG (38,54 milion € në vit)
<p>Grande për mësim parashkollor dhe shkollor deri në mësim të mesëm dhe të lartë, dhe për institucionet që ofrojnë arsim të tillë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Partneritete (grante për partneritete shkollore trans-nacionale) • Rrjetë (2,843 mil/ në vit) (grante për formimin e rrjetit të institucioneve shkollore dhe organizim të projekteve multilaterale) • Mobilim (24,793 mil. në vit) (kualifikim dhe rikualifikim të punëtorëve, shkëmbim të nxënësve). 	<p>Grante për mobilim të studentëve/ profesorëve, për rrjete dhe partneritete ne arsimin e lartë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mobilim (351,1 mil. në vit) (grante individuale për student/profesor) • Projekte multilaterale (10,842 milion euro) (grante për projekte për zhvillim, modernizim dhe inovacione). • Rrjete (7,6 milion në vit) (grante për krijimin e rrjeteve tematike për përmirësimin e kualitetit në arsimimin e lartë). 	<p>Grante për nevojat mësimore profesionale pa arsimin e lartë profesional</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mobilim (122 mil. në vit) (grante për projekte trans-nacionale për mobilim të personave, për trajnim profesional dhe për trajnerë) • Projekte multilaterale (82,64mil në vit) (grante për projekte trans-nacionale për zhvillim të inovacioneve dhe kualitet në lëmin e trajnimit profesional) • Rrjete (3,682 mil në vit) (grante për projekte tematike trans-nacionale të standardeve evropiane) 	<p>Grante për mësim, projekte për arsim të të rriturit dedikuar për trajner dhe për ata që mësojnë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mobilim(2.05 mil në vit) (grante për mobilim për arsim formal dhe joformal dhe për kuadrin arsimor që specializon arsim për të rritur) • Projekte multilaterale (14 mil në vit) (grante për projekte për zhvillim, modernizim dhe inovacione në arsimin për të rritur) • Rrjete (2,557 mil në vit) (grante për krijim dhe realizim të rrjeteve Grundvig për arsim të të rriturëve) • Partneritete (19,32 mil në vit) (grante për krijim të partnerëve për mësim të të rinjve)

LLL -TRANSVERSAL PROGRAMME

E-LEARNING (8,5 mil € në vit)- grante për integrim ne IKT në sistemin për arsim dhe trajnim ne Evrope

- DISEMINIM (2,864 mil € në vit)- grante për përkrahje të projekteve për studime të cilët kanë për qëllim shpërndarje të rezultateve të programit Mësim të përrjetshëm
- GJUHË (9,147 mil € në vit)- grante për përmirësimin e mësimin dhe mësimin të gjuhëve (kualitative dhe kuantitative)
- BASHKPUNIM DHE INOVACION NË NIVEL TË POLITIKËS PUBLIKE (6,239 mil € në vit) studime dhe analiza të lidhura me politikën dhe sistemet arsimore

JEAN MONNET

- Përkrahje e aksioneve, institucione dhe asociacione të cilat punojnë në fushën e integritimit evropian

ИЗВАДОЦИ ЕСЕИ

...Unioni Evropian është njëshi kulturor. Jo vetëm kulturor por edhe trup integruar dhe krijues i Evropës moderne. Ajo është nxitës i bashkimit historik në frymën e liberal-demokracisë. Detyra kryesore e saj është ngritja e jetës shoqërore, ndërtimi i urave të bashkëjetesës, veprimin e përbashkët dhe përbashkimi me problemet, multi-etnicitetet dhe të kuptuarit ...

Në Përvjetorin e 120-të të lindjes së Rober Shumanit, në Budapest, Egon Klepash, do t'i transmetojë fjalët e njërit nga kreatorët e Evropës së bashkuar "Do të vijë dita kurë popujt e Evropës Qendrore dhe Lindore, do të jetojnë në lirinë që paraprin ". Unë ndoshta nuk do të mund ta përjetoj këtë, por ju të rinjtë, po." Ëndrra e Shumanit ishte e qartë. Në këtë Klapashi do të shton "Ne (Unioni) nuk jemi si liberalizmi , i cili është përqendruar rreth individit, as si komunizmi rreth kolektivizmit. Ne jemi te orientuar kah personaliteti dhe prandaj jemi organizatë e vlerave...

Vendin në Parlamentin Evropian e fitojnë ato vende të cilat do të tregojnë pjekuri në demokratizimin e tyre, pjekuri në fytyrën e tyre politike, pjekuri në karakterin shoqëror. Kjo është përgjegjësi e rëndë dhe rrugë me "thera" deri tek caku i dëshiruar.

Siç theksoi Oli Ren, më datë 15 maj në Bruksel, "është fakt se Evropa është bërë heterogjene, por në fakt Evropa është shumë homogjene. "Sot Evropa është e lirë dhe e ribashkuar. Ta mbajmë si të tillë ."Kjo është agjendë shumë e rëndë, por misioni i shkëlqyeshëm, ashtu siç duhet të jetë edhe konstrukcioni evropian. Kurse Maqedonia e ka çdo të drejtë të jetë pjesë e saj.

Jovançe Nedellkovski - SHMO "Naum Naumovski Borçe "-Probishtip

...Unioni Evropian është një familje e madhe e kohabitimit ndërmjet etniteteve të ndryshme kulturore, të cilat ashtu të ndërlidhura ndërmjet vete realizojnë mirëqenien e tyre politiko-ekonomike. Të jesh pjesë e UE-së do të thotë të jesh kozmopolit, të kesh identitet mjaft të fortë, ashtu që një pjesë e tij do ti dhurohet Unionit në drejtim të arritjes së nacionalizmit dhe hapjes së kufijve krah integrimi më i zgjeruara në Evropë dhe ndërlidhjen e popujve evropian. Duke u bërë pjesë e Unionit, Maqedonia do të ishte pjesëmarrëse në krijimin politikës së jashtme dhe të sigurisë, por paraprakisht do ta përmirësonte gjendjen e saj ekonomike, duke pasur parasysh faktin se prodhimet maqedonase do të plasoheshin në tregun e përbashkët evropian, por edhe investimeve nga Evropa në Maqedoni.

Jemi dëshmitar të një tranzicioni të dhimbshëm dhe të rëndë, në të cilin ekonomia e Maqedonisë, fundoset jashtë kufijve të Unionit. Zgjidhja e vetme e Maqedonisë, për dalje nga kriza ekonomike është anëtarësimi në Unionin Evropian, por në vend se të përshpejtojmë euro-integrimet, ne krijojmë përshypje se rrotullohemi në rreth, i cili duke marr parasysh gjendjen aktuale në Maqedoni, fatkeqësisht nuk ka formë të spirales...

Ndoshta nuk kemi kuptuar edhe një fakt se " Në Evropë nuk hyhet, por as edhe ajo nuk vjen tek ne; Evropa bëhet këtu në tokën tonë. Kur do të krijojmë shtet i cili do kishte qenë i aftë të qëndron krah më krah me vendet anëtare të Unionit Evropian, atëherë do të jemi pjesë e asaj familje. Atëherë nuk do të na duhen marrëveshje dhe formalitete, pasi që kultura evropiane do të bëhet përditshmëri e jonë, dhe jo vetëm maskë artificiale në karnavalin e anëtarësimit në Unionin Evropian.

Jasna Trengoska SHMO „Shën Naum Ohridski “ - akedonski Brod

...Kur do ta marrim parasysh situatën aktuale që mbretëron në Maqedoni sot, do të arrijmë të konstatojmë se nuk mund të lavdërohem shumë me situatën ekonomike, zhvillimin teknologjik, vetëdijen ekologjike, si dhe me mënyrën se si zbatohet demokracia në Republikën e Maqedonisë. Në vetëdijen tonë akoma ndjehemi si embrion i qenies liberal-demokratike me rrënjë nga "njëmendësit", embrione të cilat zhvillojnë betejë të përditshme për t'u përsosur dhe për t'i dhënë trajtë vlerave të reja të cilat duam t'i zbatojmë në shoqërinë tonë. Alternativë të cilën Republika e Maqedonisë e sheh për ndërtimin politikës së jashtme të fuqishme, për shtet të sigurt dhe stabil, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së volitshme është Unioni Evropian, e cila paraqet padyshim rreth të balancuar nga aspekti i të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe zhvillimit ekonomiko-teknologjik.

Marshall Meklaun njerëzimin e shënon si "fshat global" në të cilin të gjithë në një mënyrë janë të lidhur mes veti dhe ku ngjarjet nga njëri skaj i planetit do t'i prekin edhe banorët e skajit tjetër. Kjo nxit iniciativë dhe ofron hapjen e horizonteve të reja të mendimeve me të cilat potencohet varësia e ndërsjellët e shteteve ndaj tjetrës, si dhe nevoja për respektimin e dallimeve, mbase në atë mënyrë mund të krijohen marrëdhënie më të fuqishme, efikasitet dhe prosperitet të secilit shtet .

Igor Radevski - SHMO "Shën Naum Ohridski" -Makedonski Brod

... Zgjerimi i Unionit Evropian është akt shumë i rëndësishëm si për vendet të cilat duan që t'i bashkëngjiten Unionit, po ashtu edhe për vetë Unionin. Para se gjithash funksionimi i suksesshëm i UE-së në dekadat e kaluara e vërtetoi idenë se vetëm "Evropa e Bashkuar" do të thotë "Evropë e fortë". Me zgjerimin e UE-së dhe me hyrjen e anëtarëve të rinj rritet zona e paqes, demokracisë, stabilitet dhe prosperitet të popujve të Evropës. Me anëtarësimin në UE qytetarët fitojnë mundësi të udhëtojnë pa pengesë, të mësojnë dhe punojnë në cilën do qoftë shtet- anëtar të UE. Me këtë përmirësohet edhe mënyra e jetesës së qytetarëve të UE-së, pasi hyrja në Unionin do të thotë se këto vende kanë arit të krijojnë kushte më të mira në lëmin që i përkasin sigurisë dhe jetës së përditshme.

Rruga e përbashkët nëpër histori me popujt e tjerë evropian, si dhe me pjesëmarrje të madhe të Maqedonisë në trashëgimin e pasur kulturore të Evropës, flasin për atë se vendi i Republikës së Maqedonisë është në Unionin Evropian. Kjo në fakt është e përmbledhur edhe në vetë moton e UE-së - "In varietate concordia" që do të thotë "Të bashkuar në dallime".

Ilija Jovanov SHMO "Shën Kirili dhe Metodij" -Negotinë

... Me shume gjëra mundet me sukses t'ju bashkëngjitmi yjeve të qiellit evropian dhe fort të shkëlqejmë në mesin e tyre, sepse dielli i Maqedonisë meriton të jetë yll evropian. Asnjë majë nuk është e pakapshme për shikimin e largët të kombit maqedonas...

Borkica Trajkovska SHMO "Jane Sandanski" -Strumicë